



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
NDËRMARRJA E PASTRIMIT

Nr _____ Prot

Vlorë, më _____. ____ 2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje Mjetesh”, Ndërmarrja e Pastrimit, Bashkia Vlorë.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **50100000-6**

VLERA E FONDIT LIMIT: **4,166,667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik”; nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Pastrimit, Bashkia Vlorë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç**, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentim: Në bazë të ligjit nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon licensimin perkates sipas legjislacionit ne fuqi.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023 , 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar: **4,166,667 x0.4=1,666,667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore"

2.2.3 Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (sipas nenit 83 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit ose **83,333 (tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.**

Argumentimi: (sipas nenit 83 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020, ndryshuar me ligjin Nr.16/2024; si dhe nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.)

Sipas nenit 83 të LPP: 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

- i. në formën e garancisë bankare; ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

Sipas nenit 30 të VKM: Sigurimi i ofertës 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. 2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari. 3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

2.2.4 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2025 në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë

subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Bazuar nëpërcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

4,166,667 x 0.2 = 833,333 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Leje për ndikimin në mjedis, të tipit B, për “Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave ”.

Argumentim: *Per kryerjen e ketij sherbimi Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me lejen mjedisore ne natyren e prokurimit duke qene se natyra e punes dhe sherbimit te kerkuar si dhe vepritaria e Autoritetit Kontraktor lidhet me ndikimin e drejteperdreje ne mjedis. Per kete arsye kerkohet leja mjedisore e tipit B për “Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar.

Në mbështetje te nenit 102 te Kushtetutes dhe ne zbatim te dispozitave të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" dhe Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis",

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë **personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës**, në përbërje të të cilit të ketë **minimalisht 5 (pesë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:**

- 1 (një) motorrist;
- 1 (një) xhenerik;
- 1 (një) elektroauto
- 1 (një) gomist
- 1 (një) mekanik

Për të vërtetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik të me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- kontratat individuale të punës.
- Diplomë ose Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohe të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocerise, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, bojaxhi e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne numrin e automjeteve qe kane nevojë per kryerjen e sherbimeve, si dhe natyren dhe numrin e sherbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e*

mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

*Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar në stafin e tij, të paktën:

- **1 (një) Inxhinier mekanik/ mekatronik**, në detyrën/rolin e drejtuesit teknik.
Për punonjësin e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi diplomë perkatese si dhe kontratën noteriale te punës ku te jete percaktuar roli i tij si drejtues teknik. Drejtuesi teknik duhet të jetë me kohë të plotë pune pranë operatorit ekonomik.

Shënim : Operatori ekonomik duhet të dorëzoj listëpagesat për muajin shkurt 2025 – mars2025- prill 2025 në të cilën të figuroj stafi i lartëpërmendur.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërise, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, bojaxhi e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne numrin e automjeteve qe kane nevojë per kryerjen e sherbimeve, si dhe natyren dhe numrin e sherbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje te pakten 1 (nje) objekt per kryerjen e sherbimit te riparimit dhe mirembajtjes se mjeteve. (Ne pronesi ose me qera) Per te vertetuar sa me siper ofertuesi duhet te paraqese:

1- Ne rast se objekti eshte ne pronesi duhet te paraqitet : certifikata e pronesise.

2-Ne rast se objekt eshte me qera duhet te paraqitet : kontrata e qerases e vlefshem per te gjithë periudhen e realizimit objekt i prokurimit e shoqeruar me certifikaten e pronesise.

Shënim: Në çdo rast ,Operatorët ekonomikë për ambjentin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

*Operatori ekonomik Duhet te kete Mjet transportues per transportin e mjeteve deri ne servis pa pagesë, minimumi 1 (nje) copë (pronesi ose qera).

Per mjetin transportues (pronesi ose qera) per transportin e mjeteve duhet te paraqese lejen e qarkullimit, kolaudimin, siguracionin, certifikaten e pronesise ose kontraten e qerases nese eshte me qera.

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
-----	----------------	-------	--------------------	---------

1				Pronesi/qira/perdorim
---	--	--	--	-----------------------

Per permbushjen e kesaj pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nepermjet Sistemit Elektronik te Prokurimeve dokumentacion provues si me poshte:

Per mjetin transportues (pronesi ose qera) per transportin e mjeteve duhet te paraqese lejen e qarkullimit, kolaudimin, siguracionin, certifikaten e pronesisë ose kontraten e qerasese nese eshte me qera.

Shënim :

Operatorët ekonomikë për mjetin që disponon duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentat që vërtetojnë që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose me huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit të prokurimit.

2.3.5Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit, të paktën 1(një) copë;
- b) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, të paktën 1 (një) copë;
- c) pajisje për kontrollin dhe furnizimin e gazit të A/C;
- d) pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v & 24v;
- e) pajisje ura ngritese për automjetet, ku te pakten njera nga urat te jete me kapacitet ngrites mbi 3,5 ton;
- f) pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.
- g) Pajisje per zevendesimin e alkolit te sistemit te frenimit

Per permbushjen e kesaj pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nepermjet Sistemit Elektronik te Prokurimeve dokumentacion provues si me poshte:

Fatura blerje/ fatura zhdoganimi/kontrata qiraje noteriale/ kontrate huapërdorje noteriale.

Pajisjet që do të deklarohen detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se,

këto pajisje dhe insntumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

* Ne rastin e ndodhjes se servisit jashte territorit ku ushtron aktivitetin Autoritetit Kontraktor NSHP BASHKIA VLORE, operatori ekonomik do te marre persiper te kryeje me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje te automjeteve qe kane nevojte per sherbime. Për realizimin e kësaj pike operatori ekonomik të lëshoj një deklaratë që merr përsipër transportin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku një pjese e tyre mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin te objektit te prokurimit

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001 sipas objektit te kesaj kontrate (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 14001 sipas objektit te kesaj kontrate (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

AK rezervon mundesine e verifikimit te certifikatave prane DPA ne Ministrine e Financave.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Iso 14001 parashikon nje sistem te menaxhimit te mjedist sipas standarteve europiane, si ne pjeset e kembimit qe do te perdoren ashtu dhe ne menyren e mexhimit te sherbimit te mirembajtjes dhe riparimit te automjeteve te Autoritetit Kontraktor. Me ane te kesaj kerkese AK kerkon nga operatori ekonomik garanci ne menaxhimin e mjedisit sipas standarteve nderkombetare te akredituara.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të deklaroj se Agregatat / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku një pjese e tyre mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë se Agregatat / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikime teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën: **05 /06 /2025.**